



Përmbatja

I.	Hyrje.....	2
II.	Raporti i monitorimit të buxhetit të INSTAT Janar-Gusht 2023	2
III.	Analiza e realizimit të buxhetit të INSTAT Janar-Gusht 2023	4

Aneksat bashkëlidhur:

- Aneksi Nr. 1-Raporti i shpenzimeve sipas programeve
- Aneksi Nr. 2-Raporti i shpenzimeve të programit sipas artikujve buxhetorë
- Aneksi Nr. 3-Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit
- Aneksi Nr. 4-Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit
- Aneksi Nr. 5-Projektet e investimeve me financim të brëndshëm dhe të huaj



I. HYRJE

Monitorimi i buxhetit të INSTAT për vitin 2023 përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Strukturat e INSTAT-it kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar dhe të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit të INSTAT-it të përfshirë në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026.

Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të INSTAT-it të detajuar në nivel kategorie shpenzimi buxhetor, nëpërmjet treguesve të planifikuara, duke mundur në këtë mënyrë riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

II. RAPORTI I MONITORIMIT TË BUXHETIT TË INSTAT JANAR-GUSHT 2023

Programi 01320 “Veprimtaria Statistikore”

Buxheti i akorduar për programin “*Veprimtaria statistikore e INSTAT-it*”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit të hartuar gjatë procesit të PBA 2023-2025 dhe është në funksion të realizimit të Politikës së Programit.

INSTAT, mbështetur në Ligjin Nr.17, datë 05.04.2018 “Për Statistikat Zyrtare” është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Misioni i tij është të prodhojë statistika asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit. Programi i Statistikave Zyrtare, 2022-2026, përcakton strategjinë e zhvillimit të statistikave zyrtare dhe Sistemit Kombëtar Statistikor, duke synuar përmbushjen e kërkesave të përdoruesve për statistika cilësore. Programi përmban aktivitetet statistikore, të cilat janë në funksion të zbatimit të strategjisë dhe prioriteteve të institucionit.

Politika e këtij programi konsiston në prodhimin e të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke u përqëndruar në fenomene thelbësore për vendimmarrësit, si dhe duke respektuar të drejtën e qytetarëve për të dhëna zyrtare, në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Institucionit, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në implementimin e objektivave që bëjnë të mundur përmbushjen e standardeve të vendosura nga BE, në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të përdorimit të burimeve njerëzore dhe financiare të INSTAT-it.



Politika e këtij institucioni është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e me cilësi e të dhënave statistikore në fushat ekonomike, sociale, të zhvillimit demografik dhe mjedisor në nivel qendror dhe lokal.
- Përdorimi i burimeve të të dhënave dhe instrumenteve të duhura, për të përmirësuar prodhimin dhe cilësinë e treguesve dhe shërbimeve statistikore.
- Përmirësimi profesional dhe organizativ i Sistemit Kombëtar Statistikor.
- Zhvillimi i sistemeve inovative ITC për përpunimin statistikor, shkëmbimin e të dhënave dhe komunikimin.

Menaxhimi i buxhetit është fokusuar në financimin e shpenzimeve në funksion të përmbushjes së objektivave prioritare strategjike të mëposhtme:

- Përmirësimin e cilësisë së realizimit të vërtetimit, duke përdorur teknika moderne për grumbullimin e përpunimin e të dhënave, si dhe duke rritur kapacitetin profesional të punonjësve mbështetës nëpërmjet trajnimeve.
- Zgjerimin e fushës së mbulimit me aktivitete të reja sipas kërkesave të përdoruesve dhe të rrisë numrin e njësive statistikore (njësi ekonomike dhe familje) të intervistuar në vërtetimet statistikore.
- Paraqitjen e një produkti statistikor të përmirësuar cilësor dhe sasior tek përdoruesit nëpërmjet publikimeve statistikore, zhvillimit të konferencave, interpretimit të tyre me mjete të ndryshme komunikimi.
- Mirëmenaxhimin e institucionit, duke aplikuar një menaxhim të lartë administrativ të burimeve financiare dhe njerëzore.
- Përditësimin e infrastrukturës së nevojshme për kryerjen e proceseve të përpunimit të të dhënave.
- Pajisjen e punonjësve me bazën e nevojshme materiale dhe kompjuterike për përpunimin e të dhënave, si dhe të krijohen kushte të përshtatshme pune për punonjësit nëpërmjet mobilimit të zyrave.



III. ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË INSTAT JANAR-GUSHT 2023


Shpenzimet faktike të Programit sipas artikujve për vitin 2023

Buxheti i Institutit të Statistikave për vitin 2023, i miratuar me Ligjin Nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, i ndryshuar është **1,686,952.0** mijë lekë.

Këto fonde, INSTAT i administron në një program “Veprimtaria Statistike”, si më poshtë:

Mijë lekë			
Artikulli	Emërtimi i artikullit	Buxheti fillestar vjetor 2023	Buxheti rishikuar vjetor 2023
6000000	Pagat	408,229.0	488,289.0
6010000	Kontributi i sigurimeve shoqërore	69,171.1	82,720.0
6020000	Mallra dhe shërbime	496,426.0	557,495.0
6040000	Transferta korrente të brendshme	1,574.0	1,574.0
6060000	Transferta buxhetesh familjare	0.0	1,274.0
	Totali i shpenzimeve korrente	975,400.0	1,131,352.0
	Investime	555,600.0	555,600.0
	TOTALI	1,531,000.0	1,686,952.0

Pesha specifike sipas zërave të shpenzimeve, të planifikuara mbi totalin e shpenzimeve paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm:



Sic shihet nga grafiku, zëri “Paga Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” zë 34% të buxhetit, zëri “Mallra dhe Shërbime” zë 33% të buxhetit dhe zëri “Investime” zë 33% të buxhetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave për 8-mujorin 2023 krahasuar me planin e vitit, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

“Veprimtaria statistikore”

Artikulli	Emërtimi i artikullit	Mijë lekë			
		Plani vjetor i rishikuar	Plani 8-mujor 2023	Fakti 8-mujor 2023	% e Realizimit plan/fakt 8-mujor
6000000	Paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore	571,009.0	432,719.0	398,584.2	92.1
6020000	Mallra dhe shërbime	557,495.0	333,764.0	27,360.5	8.4
6040000	Transferta korrente të brendshme	1,574.0	1,574.0	224.7	14.3
6060000	Transferta për buxhete familjare	1,274.0	1,274.0	652.9	51.2
	Totali i shpenzimeve korrente	1,131,352.0	769,331.0	426,822.3	61.7
2310000	Investime	355,600.0	355,600.0	282,663.4	79.4
	Totali i buxhetit	1,486,952.0	1,124,931.0	709485.7	67.7
	Financim i huaj	200,000.0	200,000.0	62,831.8	31.4
	Totali të ardhura jashtë limiti	0.0	0.0	5,458.2	0.0
	TOTALI	1,686,952.0	1,324,931.0	777,775.7	58.7

1- “Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore”. Llogaria 600-601

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit i ndryshuar për 8-mujorin 2023 për zërin “Paga, Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” është 432,917.0 mijë lekë, nga të cilat janë shpenzuar 398,584.2 mijë lekë, ose 92.1 % e planit 8-mujor 2023.

Fondet e akorduara për zërin “Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore” janë bërë në bazë të shkresës Nr. 1119 Prot. datë 18.07.2023 ku u shtuan 35,551 mijë lekë, shkresës Nr. 1273 Prot. datë 03.07.2023 ku u shtuan 28,058 mijë lekë si rezultat i zbatimit të V.K.M-së 242, datë 20.4.2023 Për disa ndryshime në vendimin Nr. 234, datë 20.04.2022 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të Institucioneve Buxhetore dhe të nëpunësve të disa Institucioneve Buxhetore” të ndryshuar, si dhe V.K.M-së Nr. 325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”

Në zërin “Paga, Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” përfshihen pagat e punonjësve të strukturës të INSTAT-it, si dhe pagat e punonjësve me kontratë të përkohshme pune, për organizimin dhe zhvillimin e anketave, mbështetur në përllogaritjen e numrit të punonjësve të domosdoshëm sipas pozicioneve, duke mbajtur parasysh kontributin e çdo pozicioni në secilën anketë.

Mosrealizimi ka ardhur kryesisht nga mosplotësimi mesatarisht i 10 vendeve vakante të strukturës organike. Gjatë 8-mujorit 2023 janë zhvilluar 29 proçedura konkurimi, ku 30 proçedura kanë përfunduar me fitues, 3 proçedura pa fitues, 3 proçedura janë mbyllur me listë pritje dhe 14 largime (dorëheqje, dalje në pension pleqërie dhe pezullim statusi).



2- “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera”. Llogaria 602

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit i ndryshuar për 8-mujorin 2023 për zërin “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera” është 333,764.0 mijë lekë dhe janë shpenzuar 27,360.5 mijë lekë ose 8.2% e planit 8-mujor.

Fondet e akorduara për zërin “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera” janë bërë në bazë të shkresës Nr. 1119 Prot. datë 13.06.2023 ku u shtuan 91,693 mijë lekë si rezultat i zbatimit të V.K.M-së 242, datë 20.4.2023 Për disa ndryshime në vendimin Nr. 234, datë 20.04.2022 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të Institucioneve Buxhetore dhe të nëpunësve të disa Institucioneve Buxhetore” të ndryshuar.

Mosrealizimi ka ardhur kryesisht për arsye se kontratat e procedurave të prokurimeve janë në zbatim. INSTAT po zhvillon Anketën e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave. Anketuesit janë me kontratë shërbimi dhe pagesa e tyre zë pjesën më të madhe të shpenzimeve operative, pagesë e cila do të kryhet në vazhdim.

3- “Transferta korrente të brendshme”. Llogaria 604

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për 8-mujorin 2023 për zërin “Transferta korrente të brendshme” është 1,574 mijë lekë dhe nga këta janë shpenzuar 224.7 mijë lekë, ose 14.3 % e fondit 8-mujor.

4- “Transferta për buxhete familjare”. Llogaria 606

Gjatë periudhës Janar-Gusht 2023 për zërin “Transferta për buxhete familjare” janë shpenzuar 652.9 mijë lekë, ose 51.2% e fondit, për daljen në pension të 4 punonjësve dhe për kompesim të telefonisë celulare.

Fondet e akorduara për zërin Fondi i Veçantë janë bërë në bazë të shkresës Nr. 151 Prot. datë 31.01.2023 ku u shtuan 650 mije lekë, shkresës Nr. 150 Prot. datë 31.01.2023 ku u shtuan 624 mijë lekë me transferim fondi nga llogaria 602 te llogaria 606 për kompesim të telefonisë celulare.

5- “Shpenzime për Investime”. Llogaria 231

Bazuar në ligjin Nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, plani i buxhetit për “Shpenzime për Investime” nga buxheti i shtetit është në shumën 355,600.0 mijë lekë.

Realizimi i Investimeve me Financim të Brendshëm është 282,663.4 mijë lekë ose 79.5%.

Realizimi i Investimeve me Financim të Brendshëm sipas zërave për periudhën Janar-Gusht 2023 është si më poshtë:

Emërtimi	Mijë lekë		
	Plani 8-mujor	Fakti 8-mujor	Realizimi %
Pajisje të teknologjisë së informacionit të blera	293,733.0	270,732.0	92.1
T.V.SH	16,835.0	8,551.9	50.7
Rikonstruksion Godine	39,000.0	0.0	0.0
Projektim Godine	1,000.0	0.0	0.0
Infrastruktura e nevojshme software	5,032.0	3,379.5	67.2
Totali i Investime	355,600.0	282,663.4	79.5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Realizimi i shpenzimeve me “Financim të Huaj” është 62,831.8 mijë lekë.

Projektet që menaxhohen nga INSTAT-i janë si më poshtë:

1. SALSTAT - Statistika të Forta Vendore.
2. Mbështetje për CENS.
3. IPA 2019 Multi-Beneficiary Statistical Cooperation Programme.
4. Sida Direct Funding - Instat Census 2022.

6- Shpenzime nga “të Ardhurat jashtë limitit”

Shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit për periudhën Janar-Gusht 2023 janë 5,458.2 mijë lekë për shpenzime operative.

Gjatë periudhës Janar-Gusht 2023 janë likuaduar të gjitha detyrimet ndaj të tretëve sipas afateve ligjore.

INSTAT-i nuk ka detyrime të prapambetura.

Realizimi i shpenzimeve *sipas produkteve* për periudhën Janar-Gusht 2023 paraqitet si më poshtë:

8-mujori viti 2023						
Llogaria Ekonomike	Produkti	Output Code	Plan Fillestar	Plan Rishikuar	Fakt 8-mujor	% Realizimi
6000000	Njësi statistikore të vrojtuar	95001AA	156,723.0	212,887.0	172,492.9	81.0
6010000	Njësi statistikore të vrojtuar	95001AA	27,755.0	37,142.0	27,150.5	73.1
6020000	Njësi statistikore të vrojtuar	95001AA	405,040.0	496,733.0	3,821.4	0.8
2310000	Financim I huaj	GM50002	200,000.0	200,000.0	62,831.8	31.4
6060000	Njësi statistikore të vrojtuar	95001AA	0.00	0.0	0.0	0.0
	Totali i njesive statistikore te vrojtuar		789,518.0	946,762.0	266,296.5	28.1
6020000	Te dhena statistikore te publikuara	95001AB	0.00	0.0	0.0	0.0
6000000	Personel i trajnuar	95001AC	251,506.00	275,402.0	167,909.9	61.0
6010000	Personel i trajnuar	95001AC	41,416.00	45,578.0	31,031.0	68.1
6020000	Personel i trajnuar	95001AC	91,386.00	60,762.0	23,539.1	38.7
6040000	Personel i trajnuar	95001AC	1,574.00	1,574.0	224.7	14.3
6060000	Personel i trajnuar	95001AC	0.00	1,274.0	652.9	51.2
	Totali Personel i trajnuar		385,882.0	384,590.0	223,357.5	58.1
6020000	Auditime te kryera.	95001AD	0.0	0.0	0.0	0.0
2310000	Infrastruktura e nevojshme software- te perditsuara	M500011	5,032.00	5,032.00	3,379.5	67.2
2310000	Pajisje te teknologjise se informacionit te blera	M500002	310,568.00	293,733.00	270,732.0	92.2
2310000	TVSH	M500005	0.00	16,835.00	8,551.9	50.8
2310000	Rikonstruksion Godine	M500009	40,000.00	39,000.00	0.0	0.0
2300000	Projektim Godine	M500004	0.00	1,000.00	0.0	0.0
	Totali i investimeve nga buxheti		355,600.0	355,600.0	282,663.4	79.5
	Te ardhura jashte limitit		0	0.0	5,458.2	0.0
	TOTALI		1,531,000.0	1,686,952.0	777,775.7	46.1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Shpenzimet për produktin “Njësi statistikore të vrojtuar” janë 266,296.5 mijë lekë ose 28.1 % e krahasuar me planin vjetor. Ndërsa shpenzimet për produktin “Personel i trajnuar” janë 223,357.5 mijë lekë ose 58.1%. Realizimi në sasi sipas **treguesit të performancës/produktit** për periudhën 8-mujore paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i Treguesit të Performancës/Produktit	Plan	Fakt 8-mujor	% Realizimit
1	Njësi statistikore të vrojtuar	1,025,521	171,864	16.7
2	Të dhëna të publikuara	167	109	65.3
3	Personel i trajnuar	236	228	96.6
4	Auditime të kryera	7	6	85.7
5	Blerje Liçensa	10	6	60.0
6	Blerje paisje kompjuterike	7830	7,700	98.3
7	Rikonstruksion Godine	1	0	0.0
8	Projektim Godine	1	0	0.0

Treguesi i performancës/produktit “Njësi statistikore të vrojtuar” është realizuar 16.7% e planit vjetor.

Treguesi i performancës/produktit “Të dhëna të publikuara” është realizuar 65.3%.

Treguesi i performancës/produktit “Personel i trajnuar” është realizuar 96.6%.

Treguesi i performancës/produktit “Auditime të kryera” është realizuar 85.7%.

Treguesi i performancës/produktit “Blerje Liçensa” është realizuar 60%.

Treguesi i performancës/produktit “Blerje paisje kompjuterike” është realizuar 98.3%.


Treguesi i performancës/produktit “Rikonstruksion Godine” nuk është realizuar.

Treguesi i performancës/produktit “Projektim Godine” nuk është realizuar.

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave për periudhën Janar-Gusht 2023 paraqitet si më poshtë:
Mijë /lekë

Art	SHPENZIMET	Plani vjetor	Plani vjetor i rishikuar	Fakti 8-mujor	% e Realizimit plan/fakt
600	Paga, sigurime shoqërore e shendetësore	477,400.0	571,009.0	398,584.2	69.8
602	Mallra dhe shërbime te tjera	498,000.0	560,343.0	33,696.3	6.1
231	Investime	555,600.0	555,600.0	345,495.2	62.1
	Totali	1,531,000.0	1,686,952.0	777,775.7	46.1

Pesha specifike sipas zërave, mbi totalin e tyre paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Referuar Regjistrin të Realizimeve të Prokurimeve Publike, për periudhën Janar-Gusht 2023 janë realizuar gjithsej:

- **Janë ndjekur dhe realizuar procedurat e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, si më poshtë:**
 1. Blerje licença, IBM SPSS Statistics Software.
 2. Rinovim Licenca.
 3. Shërbim mirëmbajtje Paisje Kompjuterike.

- **Procedura prokurimi - Blerje me vlerë të vogël, si më poshtë:**

1. Siguracion Pasurie INSTAT.
2. Siguracion i Automjeteve.
3. Shërbim Larje Automjete.
4. Monitorimi Mediatik 2023.
5. Përkthim/Noterizim.
6. Hostim Faqeje Web Gis
7. Mirëmbajtje e kondicionerëve të dhomës së serverave dhe baterisë.
8. Shërbim Profilaktik, Riparim Automjetesh

- **Procedura prokurimi - Blerje me vlerë të vogël, Sistem dinamik si më poshtë:**

1. Katër procedura Blerje Bileta Avioni.

- **Procedura prokurimi - Marrëveshje Kuadër**

1. Botim, shtypshkrime.
2. Blerje Karburant naftë/benzin në kuadër të aktivitetit të CENS.
3. Blerje Tonera.

- **Procedura prokurimi – Procedure e Hapur mbi kufirin e Larte Monetar**

1. Qera automjete për CENS në Bashki dhe Qarqe.
2. Shërbim Katering.

- **Janë ndjekur dhe realizuar procedurat e prokurimit me donatorë, si më poshtë:**

1. Rinovim Liçencë Microsoft Teams.
2. Procedura -Server Cloud
3. IT Hardware and Software -For Tablets and Laptops
4. Baza materiale CENS
5. ServerCloud for Data Storage Backup pre-enumeration app system
6. Printing
7. Blerje licensash CAL.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Alban ÇELA